



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Fatmir Krasniqi	24.05.2023	26.05.2023	2023/0300

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.05.2023, OE "" ORTHO - IMPLANTS " SH.P.K., adresa Kadri Harapi 6 Pejë ka parashtruar ankese me nr: 2023/0300, kundër njoftimit mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Sharre Borer Ortopedik” me nr. te prokurimit: 70030-23-2663-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Përgjithshëm- Pejë. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë t? hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlerë e mesme, vlera e parashikuar e kontratës: **45,000,00€**. Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 10.3 i LPP-së

Neni 10.5 i LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

--

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te lire

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i komisionit është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe me datë 11.05.2023 është ngritë në platformën elektronike E-prokurimi. Ku është rekoamnduar për kontratë OE me çmimin me te ulët.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" ORTHO - IMPLANTS " SH.P.K.**

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues –**Spitali i Përgjithshëm- Pejë**, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës, furnizim vlera e parashikuar **45,000.00€**.

AK me dt. 24.03.2023 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me

dt. 17.04.2023 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar katër operator ekonomik.

AK- Spitali i Përgjithshëm- Pejë. me dt. 11.05.2023. ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se ku për kontratë ka rekomanduar OE Agani L.T.D shpk magjistratja Prishtinë Ferizaj vlera e ofertës 18,900.00€. Ndërsa ofertën e OE ankues e kanë refuzuar si të pasuksesshme.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala ankuese fillimisht parashtron kërkesë për qasje në dokumente Publike përmes platformës E-prokurimi dhe atë me dt. 11.05.2023 ora 15:23 AK nuk ka kthyer përgjigje Pala ankues e përsërit kërkesën për qasje në dokumente prap përmes platformës E-prokurimi me dt. 15.05.2023 ora 11:04 dhe kërkesën e fundit e dorëzon me dt. 15.05.2023 ora 14:42. AK nuk ka kthyer përgjigje në asnjërën nga Kërkesat për qasje ne dokumente publike pala ankuese me dt. 16.05.2023 ka parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim tek AK brenda afatit ligjor. AK me dt 22.05.2023 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pa-bazuar OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së me dt. 23.05.2023 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta.

OE ankues, në ankesë ka paraparë një pretendim ankimore, i cili ka të bëjë me mos dhënie të qasjes në dokumente publike konform nenit 10.3 e LPP-së me ç rast i ka pamundësuar ankesën e mirëfillte me pretendime ankimore.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës në kërkesën për Ri-shqyrtim dhe ankesën e dorëzuar në OSHP, fillimisht kundërshton heshtjen e Ak-së dhe mos dhënien e qasjes në dokumente publike me ç rast konsideron se i është pamundësuar ankesa e mirëfilltë me pretendime ankimore ndaj OE te rekomanduar për kontratë.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmime në platformën E-prokurimi OE ankues kishte kërkuar qasje në dokumente tri herë dhe atë herën e parë me dt. 11.05.2023 ora 15:23 minuta kërkesa gjendet në platformë dhe AK ka pasur qasje në të, herën e dytë paraqet kërkesë me dt. 15.05.2023 ora 11:04 minuta, dhe herën e tretë paraqet kërkesë me dt. 15.05.2023 ora 14:42 minuta. Ak në asnjërën nga kërkesat e dorëzuara nga OE ankues nuk ka dhe përgjigje ndërsa në arsyeshmerinë e vendimit mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim te datës 22.05.2023 duke ju referuar nenit 10.3 AK potencon faktin se **nuk kemi informata -dëshmi qe keni parashtruar kërkesë për qasje në ofertën e operatorit të rekomanduar.**

Arsyeshmeria e dhënë nga AK nuk qëndron për faktin se tek butoni " Dokumentet-Letrat Standarde" janë të paraqitura të gjitha kërkesat e lartë cekura shih si provë screen shotin

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “” ORTHO - IMPLANTS ” SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Sharre Borer Ortopedik” me numër të prokurimit: “70030-23-2663-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Përgjithshëm- Pejë

The screenshot shows the official website of the 'Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik' (Public Procurement Regulatory Commission) of the Republic of Kosovo. The interface is in Albanian. On the left, there is a navigation menu with categories like 'PROCEDURAT E PROKURIMIT', 'PROCEDURAT E SHITJES', 'ANKESAT', 'MENAXHIMI I KONTRATËS', 'NJOFTIMET - PROKURIMET', 'NJOFTIMET - SHITJE', 'KONTRATAT E DHËNA', 'MARRËVESHJET KORRIZË E DHËNA', 'LISTA E ZEZE', 'KLASIFIKIMI LIGJOR', 'TË DHËNAT E MIA', and 'MESAZHET'. The main content area is titled 'Dosja e tenderit' (Tender File) and displays a list of documents and tenders. The list includes documents like 'Dokumentet - Letrat standarde', 'Proces verbal, Raporti vlerësimit, Vendimi B58', 'Dëshmitë e pranueshmërisë', 'Deklarata e Nivelojeve B04', 'Kommunikim me AK', and 'Dokumentet lidhur me kontratat'. It also lists tenders such as 'Përmblidhja e procedurës', 'Kërkesat për rishqyrtim', 'Sgarimet e Q7', 'Korigjimi i procedurës', 'Hapja e tenderëve', 'Vlerësimi i tenderëve', 'Publikimi i B58', 'Dhënia e kontratës', 'Drafti i kontratës', 'Nanashkimi i kontratës', 'Ndryshimi i përshkëimit të gërmimeve', 'Ankesat', 'Anulimi i procedurës', 'Anulimi i dhënies', 'Ndryshimi në dhënie të kontratës', 'Dokumentet - Letrat Standarde', 'Dëshmitë e pranueshmërisë', and 'Ndrysho menaxhimin/mbikqyrjen e kontratës'. The right side of the page shows details for specific tenders, including the tender number, the tender title, the tender type, and the date. The bottom of the page features a search bar and a list of links to various documents and tenders.

Më tej, Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK Spitali i Përgjithshëm- Pejë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 paragrafët 3 dhe 5 të LPP-së *Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.” Ndërsa paragrafi 5 “Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t’i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.*

Po ashtu AK ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 7 paragrafët 7.2 dhe 7.4 të Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022

Paragrafi 7.2 Qasja në të dhënat e aktivitetit të prokurimit fillon në datën e pranimit nga OE të njoftimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit – publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK.

Paragrafi 7.4 Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete afariste, AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për më pak se 20 faqe A4 dhe qasje

direket të formës elektronike do të jenë të liruara nga tarifa.

Si përfundim, Eksperti Shqyrtues, sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. OE ankues në mënyrë të detajuar ka argumentuar se si është shkelur neni 10 paragrafi 3 dhe 5 i LPP-së nga AK, prandaj, AK- respektivisht ZPP ti respektoj në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së. **Është përgjegjësi, dhe në diskrediton të Autoritetit kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit-ZPP**, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, dhe të trajtoj në mënyrë të barbarët të gjithë OE duke ju lejuar qasje në dokumente publike konform nenit 10 paragrafi 3, analizoj çmimin e secilit operator ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, në mënyrë që të respektohen, kriteri i dhënies së kontratës, kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosje të tenderit. Andaj , **vlerësojmë se pretendimet e palës në ankesë janë të qëndrueshme.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " ORTHO - IMPLANTS " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Sharre Borer Ortopedik" me numër të prokurimit: "70030-23-2663-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Pergjithshem- Pejë

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Spitali i Pergjithshem- Pejë**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" ORTHO - IMPLANTS " SH.P.K.**

Fatmir Krasniqi

